



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së Nr.1-020/04-28890 të datës 14.06.2024, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

### Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar dhe
3. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim, anëtar

### Neni 2 Detyrat e Komisionit

1. Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e grurit në parcelat në pronësi të shkollës "Adem Gllavica" në Lipjan, duke u bazuar në kërkesën e DKA-së Nr.1-020/04-28890 të datës 14.06.2024.
2. Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-28890  
Lipjan, më 18.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

### Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për evidentimin e hapësirave publike në pronësi komunale me qëllimi të mirëmbajtjes dhe investimeve të nevojshme, në përbërje si vijon:

1. Ramadan Dërnagllava , Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Kryesues,
2. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar dhe
3. Armend Aliu, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar

### Neni 2 Detyrat e Komisionit

1. Detyrë e Komisionit është që të bëjë evidentimin e saktë në terren të sipërfaqesë së parëqeve dhe hapësirave tjera publike që gjenden në vendbanimet e Komunës së Lipjanit me qëllim që Komuna të ketë të dhënat e sakta për mirëmbajtjen dhe investimet e nevojshme të Komunës.
2. Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi dhe për punën e vet do t'i raportoj me shkrim Zyrës së Kryetarit të Komunës.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/01-30093  
Lipjan, më 24.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

## VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

### Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për evidentimin e rrugëve të paasfaltuara në qytetin e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Ilir Shala , Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Kryesues,
2. Gafurr Hetemi, Sektori për Çështje Pronëso- Juridike, anëtar
3. Besart Zejnullahu, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar

### Neni 2 Detyrat e Komisionit

1. Detyrë e Komisionit është që të bëjë evidentimin e saktë në terren të rrugëve të paasfaltuara në qytetin e Lipjanit.
2. Të evidentoj pronësin e rrugëve si dhe gjendjen kadastrale të rrugëve paasfaltuara që gjenden në qytetin e Lipjanit.
3. Të evidentoj sipërfaqen e saktë të rrugëve të paasfaltuara që gjenden në qytetin e Lipjanit.
4. Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi dhe për punën e vet do t'i raportoj me shkrim Zyrës së Kryetarit të Komunës.

### Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-30095  
Lipjan, më 24.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për avancimin e rinisë dhe kulturës dhe përmbushjen e objektiv të thirrjes publike në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-27167 të datës 03.06.2024, në përbërje si vijon:

1. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Medina Publica, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Miranda Karpuzi, nga OJQ-të, anëtar
5. Ganimete Osmani, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Adelina Rexhepi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezerv

**Neni 2**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për avancimin e rinisë dhe kulturës dhe përmbushjen e objektiv të thirrjes publike në Komunën e Lipjanit konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-27167 të datës 03.06.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-30698  
Lipjan, më 27.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit “Mergata Fest and Sports 2024” që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-26243 të datës 28.05.2024, në përbërje si vijon:

1. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Shahadije Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Art Krasniqi, nga OJQ-të, anëtar
5. Ganimete Osmani, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezerv

**Neni 2**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit “Mergata Fest and Sports 2024” konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-26243 të datës 28.05.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t’i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

1. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.020/04-29286 i datës 18.06.2024

1Nr. 020/04-29426  
Lipjan, më 19.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak së një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

**Neni 1  
Përbërja**

Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik për marrjen, shfrytëzimin dhe vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike në fushën e kompetencës nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, në këtë përbërje:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuese
2. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
3. Salihe Marevci, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare

**Neni 2  
Detyrat përgjegjësitë dhe mandati**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për shfrytëzimin e hapësirave publike që janë në kompetencë të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Komisioni do të bëjë shqyrtimin e këtyre kërkesave në bazë të kriterëve të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak së një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike të Komunës së Lipjanit si dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi dhe pas shqyrtimit i rekomandon Drejtorit të Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim aprovimin apo refuzimin e kërkesës.

2. Mandati i komisionit është dy (2) vite.

**Neni 3  
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/01-29084  
Lipjan, më 18.06.2024



KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

## VENDIM

### MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS 2024-2026

#### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026

#### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Plani i Veprimit Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës 2024-2026 ose në email adresën [brahimduriqi@hotmail.com](mailto:brahimduriqi@hotmail.com), më së largu me datë 18.06.2024.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 610/01-27159

Lipjan, më 03.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmet





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA  
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- AKCIJSKI PLAN PROTIV NAPUŠTANJA I  
NEUPISIVANJA U ŠKOLOVANJE 2024-2026

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Akcijski Plan protiv napuštanja i neupisivanja u školovanje 2024-2026

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt- Akcijski Plan protiv napuštanja i neupisivanja u školovanje 2024-2026 na email adresu: [brahimduriqi@hotmail.com](mailto:brahimduriqi@hotmail.com) naj kasnije do 18.06.2024.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 610/01-22159

Lipljan, 03.06.2024

PREDSEDNİK OPŠTINE

Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 , Listës përfundimtare të përfituesve të frezave të publikuara nga Komisioni me Nr.12-320/01-28022 e datës 07.06.2024 , pas përfundimit të procedurave të ankesave, Kryetari i Komunës nxjerr:

**VENDIM**  
**PËR NDARJEN E FREZAVE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, NDAHEN 273 (dyqind e shtatëdhjetë e tri) freza, me qëllim të subvencionimit të fermerëve të Komunës së Lipjanit, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.12-320/01-7064 të datës 06.02.2024 dhe të cilët janë renditur në tabelën vijuese:

Nr.	Emri	Emr i Prindit	Mbiemri	Vendbanimi
1	Azem	Hajdin	Rizani	Lluge
2	Adem	Ilaz	Selmani	Babush I Muhagjerve
3	Adem	Muharrem	Stullca	Dobraje e Madhe
4	Adem		Zekaj	Hallaq I Vogel
5	Adem	Brahim	Seferi	Rufc I Ri
6	Adem	Vehbi	Shamolli	Shale
7	Adnan	Avni	Pajaziti	Gadime e Eperme
8	Adrian	Etem	Zaskoku	Rubovc
9	Afrim	Aziz	Sllamniku	Topliqan
10	Afrit	Raif	Banulla	Topliqan
11	Agim	Ramadan	Mollopolci	Gracke e Vogel
12	Agron	Zenun	Olluri	Krojmir
13	Ahmet	Ibrahim	Sopa	Gracke e Vogel
14	Ali	Bajram	Rexhepi	Rufc I Vjeter
15	Ali	Feti	Pacolli	Sllovi
16	Amir	Hazbi	Sahiti	Banulle
17	Arben	Kadri	Krasniqi	Smallushe
18	Arjan	Shaban	Jezerci	Rubovc
19	Arlind	Ismet	Jashari	Banulle

20	Arsim	Izjah	Maxheri	Kojskë
21	Arsim	Ibush	Emini	Gumnaselle
22	Arton	Mehdi	Thaqi	Smallushe
23	Avdi	Sahit	Ismajli	Hallaq I Vogel
24	Avdullah	Hashim	Podvorica	Kojsk
25	Avni	Tefik	Pacolli	Smallushe
26	Abedin	Mehdi	Ademi	Gadime e Eperme
27	Bajram	Hysen	Bajrami	Medvec
28	Bajrush	Adem	Alija	Gadime e Ulet
29	Bardhyl		Kacabashi	Topliqan
30	Bashkim	Sabit	Zejnullahu	Banulle
31	Bashkim	Fazli	Avdyli	Shale
32	Bedri	Faik	Ibrahimi	Gadime e Eperme
33	Bedri	Vesel	Demiri	Gadime e Eperme
34	Beg	Murat	Sopa	Gracke e Vogel
35	Behxhet	Bajram	Xhema	Gracke e Vjeter
36	Bekim	Hasan	Rashiti	Gracke e Vjeter
37	Beqir	Fadil	Krasniqi	Konjuh
38	Besim	Sali	Fejzullahu	Gadime e Eperme
39	Besim	Sadik	Banulla	Topliqan
40	Blerim	Milaim	Rrustemi	Banulle
41	Blerim	Munish	Luma	Kraishte
42	Blerim		Qerkini	Leletiq
43	Bleron	Agim	Rama	Ribar I Madh
44	Braim	Xhemshir	Alija	Gadime e Ulet
45	Bujar	Ragip	Çadraku	Vershec
46	Burhan	Njazi	Krasniqi	Smallushe
47	Burim	Islam	Zejnullahu	Gllgovc
48	Burim	Rexhep	Selimi	Llugaxhi
49	Daut	Hafir	Sahiti	Poturovc
50	Driton	Fehmi	Bajrami	Medvec
51	Driton	Qerim	Merovci	Rufc I Ri
52	Dulë	Shaban	Bytyqi	Sllovi
53	Ekrem	Miftar	Miftari	Gadime e Eperme
54	Elmi	Bafti	Sylejmani	Topliqan
55	Emin	Rrahman	Kozhani	Ribar I Madh
56	Emrush	Qazim	Bytyqi	Sllovi
57	Emrush	Asllan	Krasniqi	Smallushe
58	Enver	Nazif	Buja	Bujan
59	Enver	Mustafe	Ujupi	Gadime e Ulet
60	Enver	Halit	Gashi	Janjeve
61	Enver	Zenel	Peqani	Topliqan
62	Erblin	Sadat	Spahiu	Smallushe
63	Esat	Mustafe	Krasniqi	Smallushe
64	Fadil	Shefki	Mehmeti	Gadime e Eperme
65	Fahri	Haqif	Zejnullahu	Banulle
66	Fahri	Bajram	Vesiqi	Ribar I Madh

67	Faik	Rifat	Zeqiri	Hallaq I Madh
68	Faik	Qerim	Bytyqi	Qylage
69	Fatmir	Ragip	Rexhepi	Gadime e Eperme
70	Faton	Qerim	Bytyqi	Sllovi
71	Feim	Rizah	Pajaziti	Gadime e Eperme
72	Fejza	Mustafe	Olluri	Krojmir
73	Ferat	Mehmet	Kaleshi	Qellapek
74	Fidan	Agim	Salihu	Banulle
75	Fisnik	Daut	Mukulani	Dobraje e Madhe
76	Fitim	Heset	Dragaqina	Bujan
77	Fitim	Fehmi	Gashi	Sllovi
78	Flurim	Hasan	Zani	Zllakuqan
79	Gafurr	Avdullah	Limani	Gadime e Eperme
80	Gani		Jashari	Babush I Muhagjerve
81	Gani		Ismajli	Gadime e Eperme
82	Gojart	Shaqir	Sylejmani	Konjuh
83	Granit	Tahir	Bajrami	Banulle
84	Habib	Hysen	Abdullahu	Rufc I Vjeter
85	Hafiz	Raif	Banulla	Topliqan
86	Haki	Nazif	Miftari	Gadime e Eperme
87	Haki	Ibush	Rrahmani	Sllovi
88	Halim	Eshref	Buja	Bujan
89	Halim	Bajrush	Ajvazi	Dobraje e Madhe
90	Hamdi	Ahmet	Xhemajli	Llugaxhi
91	Hamdi	Sahit	Marevci	Marec
92	Hamdi	Fehmi	Shala	Shale
93	Hamit	Habib	Hoti	Ribar I Madh
94	Haqif	Hasan	Rizani	Lluge
95	Hasan	Emrush	Rrahmani	Gadime e Ulet
96	Hasan	Halit	Hoxha	Qellapek
97	Hashim		Drenica	Shale
98	Hashim	Idriz	Ahmeti	Torine
99	Hasim	Muharrem	Aliu	Hallaq I Vogel
100	Haxhere		Qeriqi	Krojmir
101	Haxhi	Hasan	Sinani	Resinoc
102	Haxhi	Ramadan	Nishori	Vershec
103	Heset	Halit	Hoxha	Qellapek
104	Hetem		Spahiu	Gadime e Ulet
105	Hetem	Elez	Sylejmani	Leletiq
106	Ibrahim		Stullca	Dobraje e Madhe
107	Ibush	Asllan	Syla	Medvec
108	Idriz	Esat	Mehmeti	Babush I Muhagjerve
109	Idriz	Ibush	Zeka	Gadime e Ulet
110	Ilaz	Hysen	Bytyqi	Sllovi
111	Ilaz	Milazim	Shala	Kleqk
112	Illir	Bajrush	Ismajli	Gadime e Eperme
113	Imer	Nezir	Gashi	Sllovi

114	Imri	Abedin	Bytyqi	Lipjan
115	Imri	Shaban	Magashi	Llugaxhi
116	Irfan	Faik	Miftari	Gadime e Eperme
117	Isa	Neshat	Osmani	Topliqan
118	Isak	Beqir	Krasniqi	Konjuh
119	Isak	Ali	Qeriqi	Krojmir
120	Islam	Daut	Gashi	Hallaq I Vogel
121	Islam	Rrustem	Trolli	Topliqan
122	Ismail	Halil	Terpeza	Ribar I Madh
123	Ismail	Jakup	Semetishti	Topliqan
124	Ismajl	Adem	Hashimi	Babush I Muhagjerve
125	Ismajl	Bajram	Mehmeti	Dobraje e Madhe
126	Ismet	Sejdi	Dragaqina	Bujan
127	Ismet	Qerim	Demiri	Gadime e Eperme
128	Ismet	Nazmi	Fejzullahu	Gadime e Eperme
129	Ismet	Mustafe	Ejupi	Gadime e Ulet
130	Ismet	Ilaz	Ahmeti	Rufc I Vjeter
131	Ismet	Imer	Thaqi	Smallushe
132	Isuf	Sefer	Xheladini	Dobraje e Madhe
133	Isuf	Selim	Shabani	Poturovc
134	Isuf	Azem	Sopa	Sllovi
135	Isuf	Hamdi	Pacolli	Smallushe
136	Izaim	Idriz	Latifi	Leletiq
137	Jahir	Halil	Zaskoku	Rubovc
138	Jakup	Hasim	Halili	Gumnaselle
139	Jeton	Fatmir	Goliqi	Hallaq I Vogel
140	Jeton	Shemsi	Sejdiu	Lipjan
141	Kadri	Ilaz	Krasniqi	Konjuh
142	Kadrije	Vehbi	Krasniqi	Smallushe
143	Korab	Isuf	Bresa	Gracke e Vogel
144	Kushtrim	Bajrush	Berisha	Lipjan
145	Liridon	Isuf	Dragaqina	Bujan
146	Liridonë	Fadil	Shurdhiqi	Resinoc
147	Lulzim	Rasim	Zejna	Gumnaselle
148	Lulzim	Xhelal	Krasniqi	Smallushe
149	Maliq	Ilaz	Zaskoku	Rubovc
150	Mehdi	Osmon	Bahtiri	Dobraje e Madhe
151	Mehmet	Xhevat	Dedushi	Kraishte
152	Mehmet		Behluli	Poturovc
153	Mehmet	Sherif	Mustafa	Rufc I Vjeter
154	Meriton	Hasan	Krasniqi	Sllovi
155	Meti	Naser	Qeriqi	Krojmir
156	Metush	Tahir	Krasniqi	Lipjan
157	Muhamet	Banush	Bajrami	Banulle
158	Muhamet	Hysri	Fazliu	Poturovc
159	Muhamet	Nestret	Kryeziu	Sllovi

160	Muharrem	Aziz	Mustafa	Dobraje e Madhe
161	Muharrem	Shemsi	Bytyqi	Sllovi
162	Musli	Ismet	Kozhani	Ribar I Madh
163	Musli	Hamdi	Krasniqi	Smallushe
164	Mustafe	Bajrush	Limani	Gadime e Eperme
165	Mustafe	Avdi	Avdiu	Llugaxhi
166	Nagip	Tefik	Grajqevci	Ribar I Madh
167	Naim	Gafurr	Demiri	Gadime e Eperme
168	Naim	Ukshin	Jashanica	Ribar I Vogel
169	Naim	Gani	Krasniqi	Smallushe
170	Naser	Vehbi	Hashani	Gadime e Ulet
171	Naser	Zylfi	Kaçara	Gadime e Ulet
172	Naser	Bislim	Rrustemi	Glllogovc
173	Naser	Sabit	Tmava	Llugaxhi
174	Naser	Sabit	Hyseni	Rufc I Vjeter
175	Naser	Avdi	Karpuzi	Shale
176	Nazmi	Isa	Bytyqi	Qylage
177	Negjat	Nazmi	Limoni	Gadime e Eperme
178	Nehat	Feim	Demiri	Gadime e Eperme
179	Nehat	Ferat	Gerbeshi	Sllovi
180	Nexhat	Fetah	Hajrizi	Gumnaselle
181	Nexhmedin	Selim	Qadraku	Vershec
182	Nijazi	Haki	Kleçka	Kleqk
183	Njazi	Arif	Neziri	Gadime e Ulet
184	Nusret	Shaban	Podvorica	Kojsk
185	Parim	Beqir	Banulla	Topliqan
186	Raif	Nuredin	Demiri	Gadime e Eperme
187	Ramadan	Nazif	Ibrahimi	Glllogovc
188	Ramadan	Agim	Bardhi	Magure
189	Ramadan	Ilaz	Spahiu	Smallushe
190	Ramadan	Bajram	Krasniqi	Smallushe
191	Remzi	Bajram	Krasniqi	Smallushe
192	Rexhep	Nazmi	Bylykbashi	Baice
193	Rexhep	Nexhmedin	Bahtiri	Dobraje e Madhe
194	Rexhep	Fazli	Vllahiu	Dobraje e Vogel
195	Rexhep		Mehmeti	Glllogovc
196	Rexhep	Izet	Rexhepi	Rufc I Vjeter
197	Rexhep	Adem	Salihu	Sllovi
198	Rifat	Raif	Zeqiri	Hallaq I Madh
199	Rijad	Avni	Llugiqi	Dobraje e Madhe
200	Rrahman	Hafir	Olluri	Krojmir
201	Ruzhdi	Ilaz	Ilazi	Qylage
202	Sabedin	Gafurr	Gashi	Janjeve
203	Sabit	Avdyl	Ibrahimi	Gadime e Eperme
204	Sabri	Xhevat	Haziri	Banulle
205	Sabri	Vehbi	Bytyqi	Sllovi
206	Sabri	Eshref	Krasniqi	Smallushe

207	Sadat		Qamili	Babush I Muhagjerve
208	Sadat	Ismet	Mujaqiqi	Gadime e Ulet
209	Sadri	Aziz	Sadiku	Gumnaselle
210	Safer	Mehdi	Zeka	Gadime e Ulet
211	Safet	Qamil	Emini	Shale
212	Sahit	Sylejman	Sylejmani	Konjuh
213	Sahit		Duriqi	Ribar I Madh
214	Sahit	Rexhep	Sllamniku	Topliqan
215	Salih	Jakup	Bllaca	Ribar I Madh
216	Sami	Mustafe	Qeriqi	Krojmir
217	Sami	Bajram	Gashi	Terbuvc-Sllovi
218	Selim	Shaqir	Durmishi	Krojmir
219	Selim	Asllan	Gashi	Varigovc
220	Selvete	Adem	Krasniqi	Teqe
221	Shaban	Tahir	Sejdiu	Glllogovc
222	Shaip	Avdullah	Shabani	Hallaq I Vogel
223	Shaqir	Shaban	Buja	Bujan
224	Shefik	Ragip	Sadiku	Gumnaselle
225	Shefqet	Islam	Ajnunni	Dobraje e Madhe
226	Shefqet	Vehbi	Kryeziu	Sllovi
227	Sheremet	Shaban	Bardiqi	Magure
228	Sherif	Latif	Murati	Krojmir
229	Skender	Khavit	Bajraktari	Baice
230	Skender	Sabit	Demiri	Gadime e Eperme
231	Sylejman	Ali	Rrustemi	Dobraje e Madhe
232	Sylejman	Islam	Bllaca	Ribar I Madh
233	Tahir	Aqif	Ibrahimi	Gadime e Eperme
234	Tasim	Feriz	Qeriqi	Krojmir
235	Tefik	Behlul	Gashi	Dobraje e Madhe
236	Valdete	Aziz	Gashi	Sllovi
237	Valdrin	Fatmir	Krasniqi	Smallushe
238	Valon	Mehmet	Demiri	Gadime e Eperme
239	Vesel	Hasan	Avdiu	Llugaxhi
240	Veton	Habib	Bahtiri	Dobraje e Madhe
241	Veton	Neshat	Sylejmani	Gadime e Eperme
242	Xhafer	Muharrem	Sopa	Sllovi
243	Xhavit	Asllan	Buja	Bujan
244	Xhavit	Halil	Zeqiri	Varigovc
245	Xhevdet	Bajram	Olluri	Krojmir
246	Xhevdet	Fazli	Fazliu	Poturovc
247	Xhevdet	Adem	Bytyqi	Sllovi
248	Xhevdet	Sami	Krasniqi	Smallushe
249	Zejnullah	Bislim	Pasjaqa	Gllanice
250	Zivorad	Petar	Radiç	Lipjan
251	Shaip	Mehmet	Kaleshi	Qallapek
252	Rexhep	Bislim	Vitia	Konjuh

253	Avni	Bajrush	Isufi	Gadime e Epërme
254	Sabit	Abdullah	Duriqi	Ribar I madh
255	Qemajl	Hajrullah	Deliu	Glllogovcë
256	Destan	Rifat	Krasniqi	Smallushë
257	Sylë	Bajram	Krasniqi	Smallushë
258	Rrahim	Hetemi	Bytyqi	Akllap
259	Mufail	/	Avdyli	Shalë
260	Zekim	Ramadan	Luma	Kraishtë
261	Dukagjin	Agim	Kolshi	Baicë
262	Ahmet	Bahti	Sadiku	Poturovc
263	Skender	Bajram	Salihu	Banullë
264	Shemsi	Shaip	Buja	Bujan
265	Brikiq	Tuna	Nikola	Janjevë
266	Agim	Nezir	Kadriolli	Shalë
267	Shaip	Beqir	Drenica	Shalë
268	Burim	Adem	Tasholli	Gadime e Ulët
269	Sami	Musli	Krasniqi	Smallushë
270	Qemal	Abedin	Gashi	Janjevë
271	Ukë	Halil	Kryeziu	Sllovi
272	Maksut	Sahit	Bytyqi	Sllovi
273	Agron	/	Krasniqi	Hallaq i Madh

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe përfituesve të frezave do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjet të cilat do të lidhen në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit fermer veq e veq.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

1Nr. 320/01-28468  
Lipjan, më 11.06.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

## VENDIM

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

#### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,560.00€**, (shtatë mijë e pesëqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-26949 e datës 03.06.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 27 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin maj të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast  $27 \times 280 = 7,560.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

#### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

#### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-26949  
Lipjan, më 04.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2023, Raportin – Procesverbalin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale 5Nr.404/01-27172 të datës 03.06.2024 , duke vendosur sipas kërkesës së Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport nr.01-404/01-27308 të datës 04.06.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM**  
**PËR SHITJEN E ASETEVE KOMUNALE JASHTË PËRDORIMIT**

**Neni 1**

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Raportit- Procesverbalit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale të datës 03.06.2024, do të bëhet shitja e aseteve - inventarit jashtë përdorimit në pronësi të komunës, me çmimin fillestar për hekur 0.17 € për kg, të cilat gjenden në kuadër të objektit të Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" në Lipjan, me shënimet si në tabelën në vijim:

**Asetet e Vlerësuara**

Nr	Emri i paisjes	Sasia	Barkodi	Vlerësimi
1	Arka	1	KLyKKL1-1861	Jashtë funksionit
2	Stufë për ngrohje	1	KLyKKL1-1942	Jashtë funksionit
3	Stufë për ngrohje	1	KLyKKL1-1914	Jashtë funksionit
4	Stufë për ngrohje	1	---	Jashtë funksionit
5	Stufë për ngrohje	1	---	Jashtë funksionit
6	Rafta metali	1	KLyKKL1-7021	Jashtë funksionit
7	Rafta metali	1	KLyKKL1-7019	Jashtë funksionit
8	RAFT METALIK PËR ARKIVIMIN ME D 200X100X45VM	1	KLyKKL1-25043	Jashtë funksionit
9	Rafta metali	1	KLyKKL1-7022	Jashtë funksionit
10	Shkallë metalike	1	KLyKKL1-10235	Jashtë funksionit
11	RAFT METALIK PËR ARKIVIMIN ME D 200X100X45VM	1	KLyKKL1-25044	Jashtë funksionit

12	Orman metalik	1	KLyKKL1-1862	Jashtë funksionit
13	FOTOKOPJE Multifunction_High Volume Copy Machine	1	KLyKKL1-9977	Jashtë funksionit
14	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1863	Jashtë funksionit
15	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21162	Jashtë funksionit
16	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21161	Jashtë funksionit
17	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-403	Jashtë funksionit
18	Furnizime dhe transporti i karriakave Standarde	1	KLyKKL1-21732	Jashtë funksionit
19	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1940	Jashtë funksionit
20	Karrigë lëvizëse (Lëkurë)	1	KLyKKL1-21160	Jashtë funksionit
21	Karrigë statike	1	KLyKKL1-1913	Jashtë funksionit
22	Tavolinë	1	KDcKLP118-22907	Jashtë funksionit
23	Tavolinë	1	KLyKKL1-1859	Jashtë funksionit
24	Tavolinë	1	KLyKKL1-1860	Jashtë funksionit
25	Tavolinave me dim 160*90*72cm	1	KLyKKL1-21731	Jashtë funksionit
26	Tavolinë	1	KLyKKL1-813	Jashtë funksionit
27	Tavolinë e vogël	1	KLyKKL1-1923	Jashtë funksionit
28	Tavolinë (Për takime)	1	KLyKKL1-1922	Jashtë funksionit
29	Tavolinë	1	KLyKKL1-17551	Jashtë funksionit
30	Orman	1	KLyKKL1-1929	Jashtë funksionit
31	Orman me dy dyer	1	KLyKKL1-1934	Jashtë funksionit
32	Orman i hapur	1	KLyKKL1-1933	Jashtë funksionit
33	Rafta	1	KLyKKL1-1919	Jashtë funksionit
34	Rafta	1	KLyKKL1-1920	Jashtë funksionit
35	Rafta	1	KLyKKL1-1917	Jashtë funksionit
36	Rafta	1	KLyKKL1-1916	Jashtë funksionit
37	Sirtarë	1	KLyKKL1-17552	Jashtë funksionit
38	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-1936	Jashtë funksionit
39	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-21183	Jashtë funksionit
40	Varëse për rroba	1	KLyKKL1-1915	Jashtë funksionit
41	Kalldajë për ngrohje me dru	1	pa barkod	Jashtë funksionit
42	Radiator	33	pa barkod	Jashtë funksionit
43	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1829	Jashtë funksionit
44	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1830	Jashtë funksionit
45	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1832	Jashtë funksionit
46	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1833	Jashtë funksionit
47	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1834	Jashtë funksionit

48	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1835	Jashtë funksionit
49	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1836	Jashtë funksionit
50	Aparat kundër zjarrit	1	KLYKKL1-1837	Jashtë funksionit
51	Trafë -Shperndarës l rrymës	1	KLYKKL1-1838	Jashtë funksionit
52	Aparate kundër zjarit	7	pa barkod	Jashtë funksionit
53	Karrike për kino	353	pa barkod	Jashtë funksionit
54	Dyer hyrëse alumini	2	pa barkod	Jashtë funksionit
55	Dyer hyrëse plastike	1	pa barkod	Jashtë funksionit

### Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Drejtorati për Prokurim.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr.404/01-27308

Lipjan, më 06.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Rekomandimin e Komisionit për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit të datës 19.06.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM  
PËR SHITJEN E PRODHIMEVE BIMORE TË GRURIT**

**Neni 1**

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Rekomandimit të Komisionit për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit të datës 19.06.2024, do të bëhet shitja e prodhimeve të grurit me çmim fillestar prej 0.16 cent për kg, në sipërfaqet që janë në shfrytëzim nga SHMP " Adem Gllavica " – Lipjan, Ekonomia bujqësore.

**Neni 2**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Arsim dhe Drejtorati për Prokurim.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-29782  
Lipjan, më 21.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 duke u bazuar në Marrëveshjen e Bashkëfinancimit 01Nr.400/01-20407 të datës 24.04.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Joqeveritare “Advancing Together, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Bashkim Ibishi, Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e përgjithshme e mjeteve më vlerë prej 31.711.37 € (tridhjetë e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e tridhjetë e shtatë cent) konform dispozitave të Marrëveshjes së Bashkëfinancimit 01Nr.400/01-20407 të datës 24.04.2024, lidhur në mes të Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Z. Imri Ahmeti dhe Organizatës Joqeveritare “Advancing Together” , përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Bashkim Ibishi e cila është zbatuese e projektit “ Bëhu Partneri im për mirëqenie” i financuar nga UNMIK me qëllim të fillimit të realizimit të projektit të përbashkët përkatësisht :

- a) 27,750.00 € (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë euro) për realizimin e projektit -Faza fillestare për parkun qendror te qyteza Magurë dhe
- b) 3,961.37 € ( tre mijë e nëntëqind e gjashtë e një euro e tridhjetë e shtatë cent) për realizimin e Projektit për ndërtimin e kopshtit Qendra ditore e fëmijëve -Gadime.

### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, Fondi për bashkëfinancim me donatorë në xhirollogarinë bankare të OJQ“ Advancing Together” me nr.1189006005000158 në Procredit Bank.

### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400/01-28464  
Lipjan, më 11.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E  
KËRKESAVE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE-SUBVENCIONIM NË ZYRËN LOKALE  
PËR KOMUNITET 1NR.020/04-28784 TË DATËS 07.06.2023

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, anëtari i Komisionit Fatmir Goliqi me numer rendor tre (3) i caktuar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.020/04-28784 i datës 07.06.2023 në Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare-subvencionimin në Zyrën Lokale për Komunitete, dhe në vend të tij caktohet:

**ARBRESHA HETEMI**, Zyrtare në Zyrën Lokale për Komunitete.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Zoran Stojanevic, Kryesues i Komisionit

Arbresha Hetemi, Zyrtare në Zyrën Lokale për Komunitete

1Nr.020/04-28784/2

Lipjan, 10.06.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E ZYRTARES PËRGJEGJESE PËR QASJE NË SIMFK**

I. Me këtë Vendim, **Shehide Sopa Ibrahim**, Zyrtare më Drejtoratin për Buxhet dhe Financa **CAKTOHET**, zyrtare përgjegjëse për qasje në SIMFK si Zyrtare e të hyrave .

II. Zyrtarja e cekur në pikën I të këtij Vendimi e trajnuar dhe certifikuar paraprakisht për qasje në SIMFK si Zyrtare e të hyrave do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë, konform dispozitave ligjore në fuqi.

III. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe zyrtarja komunale Shehide Sopa Ibrahim.

1Nr. 112/02-29550  
Lipjan, më 19.06.2024

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

